

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Frika nga AfD, kishat në Saksoni-Anhalt nisin zhvendosjen e emigrantëve në rajone të tjera të Gjermanisë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/frika-nga-afd-kishat-ne-saksoni-anhalt-nisin-zhvendosjen-e-emigranteve-ne-r-i586282
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:59:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f3decc5545880c4e4db649500eaff9955cabff54f7df093f25eac97c7e012520
TEKSTI	e7953b0a2539ea0a0d4cc3104f590aa0c9acf7c33ee783bb2bf12f77184e5eea
PAMJA	435a668312f3771739cdfdb6897d4ed315b6b73b3d19906ada629c2ff192a050

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	32bb5d1ac543fb8eaf2199fe8215f3f09f09c27e64b7c3479021ab0da1ad495f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/32bb5d1ac543fb8eaf2199fe8215f3f09f09c27e64b7c3479021ab0da1ad495f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie [Frika nga AfD, kishat në Saksoni-Anhalt nisin zhvendosjen e emigrantëve në rajone të tjera të Gjermanisë](#) Soni Malaj 'ndez' rrjetin nga pushimet, shfaqet në super forme fundit

Frika nga AfD, kishat në Saksoni-Anhalt nisin zhvendosjen e emigrantëve në rajone të tjera të Gjermanisë



15 Shtator 2026, 15:55 Bota TEMA



Kishat në landin gjerman Saksonia-Anhalt kanë nisur të zhvendosin emigrantët që strehohen në kishat për mbrojtje nga dëbimi, duke i dërguar në rajone të tjera të Gjermanisë. Ky vendim lidhet me frikën nga një qeverisje e mundshme e partisë së ekstremit të djathtë AfD, e cila ka deklaruar se nuk do ta njohë më të drejtën e azilit në kisha.

Lëvizja ishte planifikuar prej kohësh, por ishte mbajtur e fshehtë për të shmangur shqetësimet. Situata u bë më urgjente pas rezultatit të fortë të AfD-së në zgjedhjet në Saksonia-Anhalt.

Stephan Reichel, drejtues i organizatës Matteo, tha se po merret me rastin e një emigranti sirian që rrezikon të dëbohet drejt Bullgarisë dhe që kishte gjetur strehim në një dioqezë të landit. Emigranti do të transferohet në Saksoni, ku nuk pritet të përballet me të njëjtin rrezik.

Në Gjermani, i ashtuquajtur "azil kishtar" nuk është i përcaktuar në ligj, por mbështetet në një traditë të vjetër dhe marrëveshje joformale mes kishave dhe autoriteteve. Kjo praktikë u jep emigrantëve kohë për të shmangur dëbimin dhe për të shqyrtuar mundësitë e tyre ligjore për të qëndruar në vend.

Peshkopi Friedrich Kramer tha se azili kishtar në Saksonia-Anhalt do të zhvendoset në rajone të tjera, pasi ekziston frika se policia mund të hyjë në kisha për të marrë emigrantët. Sipas tij, azili kishtar është një "hapësirë njerëzore" dhe një traditë që është respektuar prej shekujsh.

AFD ka deklaruar se synon të kufizojë ndjeshëm emigracionin dhe të ndryshojë politikën e azilit. Pas fitores së partisë në zgjedhjet e landit, kryepeshkopi katolik Reinhard Marx e cilësoi rezultatit si "të tmerrshëm dhe dëshpërues", duke bërë thirrje për mbrojtjen e demokracisë, lirisë dhe shtetit të së drejtës.

Edhe deklaratat e drejtuesve të AfD-së për të ashtuquajturën "remigrim", pra kthimin e emigrantëve në vendet e tyre, kanë shkaktuar reagime të forta. Lideri i partisë në Saksonia-Anhalt, Ulrich Siegmund, ka lidhur nevojën për armatim me planet për dëbimin e emigrantëve.

Këto deklarata kanë shkaktuar shqetësim te kishat dhe organizatat që mbrojnë emigrantët, të cilat paralajmërojnë se një politikë e tillë mund të rrezikojë një traditë të gjatë të mbrojtjes së njerëzve që përballen me dëbimin.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rritja e frikshme e AfD-së/ Pse demokracia gjermane s'mund të mbrohet më nga ekstremizmi?](#)

15:35 Bota

[Makina përplasët me këmbësorët dhe dy automjete, dy të vdekur dhe katër të plagosur rëndë në Britani](#)

14:05 Bota / 2 komente

Dyshohet për sabotim/ Kaos në hekurudhat e Holandës, anulohet qarkullimi i trenave

13:25 Bota

Marrja e kontrollit te Ngushtices Bab el-Mandab nga Huthit, UKB njohton mbledhje urgjente te Keshillit te Sigurise

13:15 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.